


Çka janë paratë e xhepit dhe si duhet menaxhuar ato?


Shumë kohë më parë njerëzit i mbanin paratë në çanta ose thasë të vegjël.



Më vonë, një rrobaqepësi të zgjuar, i lindi idea për të qepur një xhep në rroba, si vend më i përshtatshëm dhe më i sigurt për t'i mbajtur paratë. Kështu mendohet se ka lindur emërtimi *para xhepi*.



Sot, me para xhepi nënkuptojmë një shumë të caktuar parash që prindërit i japin fëmijës, në intervale të rregullta kohore, për t'i shpenzuar sipas dëshirës.





Këshilla për prindër që t'i ndihmojnë fëmijët në menaxhimin e parave të xhepit

Menaxhimi i parave është pjesë e rëndësishme e edukimit, sidomos kur kemi parasysh se shprehjet e fituara në fëmijëri ndikojnë në sjelljen e fëmijëve kur të rriten - nëse ata do të dijnë të menaxhojnë paratë me përgjegjësi kur të fillojnë t'i fitojnë ato.

Vetëbesimi që një fëmijë fiton duke u kujdesur për një shumë të caktuar parash është shumë i vlefshëm dhe e bën më të lehtë pavarësinë ekonomike të të rinjve në të ardhmen.

Mënyra më e mirë për të mësuar një fëmijë që të menaxhojë paratë me kujdes është duke filluar nga paratë e xhepit.



Pavarësia financiare është thelbësore

Fëmija duhet të shpenzoj paratë e xhepit sipas vlerësimit të tij.

Ai mund t'i shpenzoj paratë për çdo gjë që dëshiron, por udhëzimet gjatë blerjeve dhe këshillat rreth kursimit mund të jenë motivuese dhe të dobishme për fëmijën.



Shuma e caktuar dhe në intervale të rregullta - parimi themelor i parave të xhepit

Në mënyrë që fëmija të mësojë të respektojë marrëveshjet si diçka detyruese edhe në të ardhmen, prindërit duhet t'i përmbahen dinamikës së dakorduar të parave të xhepit.

Për të vendosur se sa shpesh duhet t'i jepni fëmijës tuaj para, duhet pasur parasysh moshën e tij. Pagesat në baza javore janë adekuate për fëmijët më të vegjël ndërsa për nxënësit e shkollave të mesme është më e pranueshme dhënia e parave në baza mujore. Në këtë mënyrë fëmija do të zhvillojë aftësitë e nevojshme për menaxhimin e suksesshëm të parave.



Përmbajuni dinamikës së dhënies së parave të xhepit dhe shmangni dhënien e parave shtesë

Mbani mend: Duke mos ia dhënë paratë e xhepit si avans (p.sh për dy muaj) ose duke mos i dhënë para shtesë përveç shumës së dakorduar, fëmija do të kuptojë një mësim të rëndësishëm të jetës: jo gjithmonë do të kemi para të mjaftueshme për të plotësuar të gjitha dëshirat impulsive që mund të kemi. Por, në marrëveshje me fëmijën, ju mund t'ia mundësoni atij të përmbushë ndonjë dëshirë duke e shpërblyer për ndonjë punë shtesë në shtëpi.



Punët shtesë duhet të shpërblehen ndaras

Nëse fëmija ka kryer ndonjë punë shtesë, kjo duhet t'i shpërblehet ndaras dhe jo të përfshihet në paratë e xhepit. Mos harroni që fillimisht të dakordoheni me fëmijët për obligimet dhe pasojat nëse ato nuk përmbushen, që do të thotë se ata nuk do të shpërblehen nëse nuk kryejnë punët shtesë për çka jeni dakorduar, në mënyrë që të zhvilloni ndjenjën e përgjegjësisë të fëmija.



Kuptimi dhe qëllimi i parave të xhepit

Qëllimi i parave të xhepit është që fëmijët t'i përdorin paratë e tyre për gjëra dytësore e jo për gjëra bazike siç janë ushqimi ose rrobat, të cilat janë përgjegjësi e prindit. *Shembull:* prindi është i obliguar t'i blej fëmijës çantën për të cilën ka nevojë sepse i është vjetruar ajo që e ka. Mirëpo, nëse fëmija insiston që përveç çantës që i nevojitet ta blej edhe një kuletë për të cilën nuk ka nevojë sepse prindi ia ka blerë para pak kohe, por thjesht po i pëlqen, atëherë blerjen e kuletës do të duhej ta mbulonte me paratë e xhepit.



Paratë e xhepit duhet të jenë në përputhje me standardin e jetesës së familjes

Një nga dilemat më të shpeshta është se sa duhet të jetë shuma e parave të xhepit. Kjo natyrisht varet nga gjendja financiare e familjes. Megjithatë, një shumë e madhe parash xhepi edhe atëherë kur është lehtë e realizueshme nga ana e familjes, do të ndikoj negativisht në përcaktimin e përparësive dhe vlerësimin e rëndësisë së menaxhimit të parasë nga ana e fëmijës.



Paratë e xhepit nuk duhet të përdoren si mjet për shpërblim ose ndëshkim

Paratë e xhepit duhet dhënë fëmijës pavarësisht rezultateve në shkollë. Rritja e shumës së parave të xhepit për shkak të notave të mira në shkollë ose reduktimi për shkak të notave të dobëta do t'i shndërronte paratë e xhepit në një mjet disipline për edukimin e fëmijës nga aspekti i përgjithshëm, por do t'a tjetërsonte qëllimin e parave të xhepit si mjet për edukim financiar.



Fëmijët mësojnë nga shembujt

Nëse prindërit japin shembuj praktik të menaxhimit të parasë dhe kursimeve në përditshmërinë e tyre, fëmija do ta ketë më të qartë nocionin e të kursyerit.

